



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.28.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT KOSOVAR
TË KONKURRENCËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR
2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Refiqe Morina (udhëheqëse e ekipit) dhe Shemsije Llugiqi (antare e ekipit) nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 10/04/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit- 2017

Menaxhmenti ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komisionit Kosovar të Konkurrencës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e KKK-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i AKK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AKK-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AKK-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr.01/2013 dhe nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PFV janë përgatitur me kohe dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të cilësisë së PFV-ve dhe kërkesave për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I AKK-së

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

AKK në përgjithësi ka kontrolle të duhura në raport me obligimet statutores të saj. Në menaxhimin financiar dhe të kontrollit kishin dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera. Megjithatë, nevojiten përmirësime në mallra dhe shërbime dhe menaxhimin e personelit, me theks të kontratat për shërbime të veçanta.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	252,965	243,518	224,087	179,476	125,979
Granti i Qeverisë -Buxheti	252,965	243,518	224,087	179,476	125,979

Buxheti final në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për 9,447€. Ky zvogëlim është rezultat i shkurtimeve buxhetore me rishikim të buxhetit.

Në vitin 2017, AKK ka shpenzuar 224,087€ apo 92% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 7% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	252,965	243,518	224,087	179,476	125,981
Pagat dhe Mëditjet	160,104	170,657	170,657	140,429	97,902
Mallrat dhe Shërbimet	59,861	59,861	43,511	38,596	26,379
Shërbimet komunale	13,000	13,000	9,919	451	1,700
Investimet Kapitale	20,000	-	-	-	-

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte rritur për 10,553€. Kjo rritje ishte rezultat i emërimit të anëtarëve të komisionit për mbrojtjen e konkurrencës.² Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 100%;
- Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nuk kishte ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe atij final. Mjetet financiare të pashpenzuar në fund të vitit ishin 16,350€, si rrjedhojë kursimeve buxhetore;
- Edhe te shërbimet komunale buxheti final nuk kishte ndryshim me atë fillestar. Mjetet financiare të pashpenzuar në fund të vitit ishin 3,081€, si rrjedhojë e kursimit në shpenzimet komunale³;
- Buxheti fillestar në kategorinë investime kapitale ishte 20,000€, të cilat ishin planifikuar për blerjen e Softuerit për nevojat e AKK-së. Këto mjete në tërësi ishin marrur me vendim të Qeverisë nr. 08/151.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e mbledhura nga AKK në 2017 ishin në vlerë 6,200€. Në raport me vitin e kaluar shihet një rritje e të hyrave për 3,200€. Këto të hyra realizohen nga përqendrimet e lejuara⁴.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	2017- Pranimet	2016- Pranimet	2015- Pranimet
Të hyrat	6,200	3,000	100
Totali	6,200	3,000	100

² Vendimi nr.05/V-294 –Për anëtarët e komisionit për mbrojtjen e konkurrencës.

³ Shpërndarja e shpenzimeve të komunalive me organizata të tjera buxhetore që gjinden me një ndërtesës.

⁴ **Nocioni i Përqendrimit:** Përqendrimi i ndërmarrjeve krijohet me vendosjen e kontrollit të përhershëm me të cilën fitohet; bashkimi i dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura ose pjesëve të këtyre ndërmarrjeve dhe kontrolli i drejtpërdrejt apo i tërthortë ose ndikimin e pozitës dominuese të një apo më shumë ndërmarrjeve ose pjesëve të ndërmarrjeve.(Më gjerësisht shih ligjin për mbrojtjen e konkurrencës). Në kërkesën me shkrim nga pjesëmarrësit e përqendrimit, AKK jep vërtetim se përqendrimi është lejuar.

Të hyrat e mbledhura nga AKK deponohen në Buxhetin e Kosovës. Nga mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave dhe pagesat sipas kontratës (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave). Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Në AKK numri i aprovuar i stafit për vitin 2017 ishte 19 pozita ndërsa në fund të vitit 2017 ishin 18 të punësuar.

Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarrura në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet tona identifikuam çështjen në vijim:

Çështja 1- Kontrata për shërbime të veçanta pa procedurë të rekrutimit

- E gjetura** Sipas nenit 12 pika 4 e LSHC nr. 03/L-149, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Ne identifikuar se AKK ka lidhur marrëveshje për shërbime të veçanta në kohëzgjatje prej gjashtë muaj pa procedurë të rekrutimit për pozitën “Inspektor Hetues i Konkurrencës”.⁵
- Rreziku** Marrëveshja për shërbime të veçanta pa procedura të thjeshtësuar të rekrutimit kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që angazhimi i stafit të bëhet në mënyrë jo transparente dhe si pasojë shërbimet e pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat e AKK-së.
- Rekomandimi 1** Kryetari i AKK duhet të siguroj se angazhimi i stafit me shërbime të veçanta bëhet duke i zhvilluar procedura e rekrutimi në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe konkurrues.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për kategorinë e mallra dhe shërbime dhe shërbimet komunale ishte 72,861€. Prej tyre ishin shpenzuar 53,430€ apo 73% e buxhetit final. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, dreka zyrtare, furnizim për zyrë dhe shpenzimet e telefonisë mobile. Nga testimet tona identifikuar çështjen në vijim.

Çështja 2 - Mos protokollimi i faturave të pranuar

- E gjetura** Sipas rregullës financiare nr. 01/2013, të gjitha faturat të cilat pranohen/protokolohen duke i zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit. Në këtë aspekt faturat e pranuar duhet të protokollohen dhe të evidentohen në librin e faturave. Ne vërejtum që jo të gjitha faturat e pranuar nga OE ishin protokolluar dhe kishin datën e pranimit nga AKK. Gjatë testimet të pagesave në 10 raste faturat nuk ishin protokolluar.
- Rreziku** Mos protokollimi i faturave e rrit rrezikun e humbjes apo pagesës së dyfishtë të të njëjtës faturë.
- Rekomandimi 2** Kryetari i AKK duhet të sigurojë se zbatohen të gjitha procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe se faturat të protokollohen në momentin e pranimit.

⁵ Totali i pagesës për këtë kontratë ishte 2,516€.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një sistem i mirëfilltë i menaxhimit të pasurive kërkon përcaktim të qartë të rrjedhjes së detyrave për regjistrimin, krahasimin, raportimin dhe shpalosjen e tyre në PFV.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores së MF nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

AKK-ja në PFV kishte shpalosur pasurin kapitale mbi 1,000€ në vlerë zero, ndërsa pasuria jo-kapitale nën 1,000€ në vlerë 14,836€, si dhe stoqet në vlerë 500€. Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.7 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 596€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Arsyeja e mos pagesës së këtyre obligimeve ishte, pranimi i faturave në vitin 2018. AKK ka një sistem të mirë kontrolli për menaxhimin e pagesave dhe raportimi i obligimeve ishte bërë në baza të rregullta mujore në Thesar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të AKK-së, ka rezultuar me gjashtë rekomandime. AKK kishte përgatitur një Plan Veprimi në të cilin kishte paraqitur mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna nga ZKA.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime ishin zbatuar, dhe dy rekomandime ishin në proces të zbatimit. Për më tepër, nga viti 2015, nga gjashtë rekomandimet e dhëna tre rekomandime ishin zbatuar në vitin 2017, dy ishin në proces dhe një rekomandim nuk ishte adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimit të rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

AKK ka marrë në konsideratë kërkesat të parapara me rregullat e MFK-së dhe ka përfunduar me kohë vetëvlerësimin. Po ashtu, AKK ka zbatuar një pjesë të rekomandimeve dhe pjesa tjetër është në proces të duhur të zbatimit, si dhe kishte përgatitur regjistrin e rreziqeve, megjithatë nuk kishte bërë monitorimin dhe azhurnimin e regjistrit të rreziqeve, të paktën tremujore.

Me gjithë progresin e realizuar, ne vlerësojmë që disa aspekte të qeverisjes brenda AKK-së kërkojnë përmirësim të mëtejshëm siç është mungesa e planit strategjik dhe monitorimi i rreziqeve.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të UA Nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, AKK-ja nuk i plotëson kriteret⁶ për themelimin e NJAB-së.

Në mungesë të NJAB-së, auditimi i brendshëm kryhet nga (DAB) në kuadër të Ministrisë së Financave (MF), si rezultat gjatë vitit 2017 nuk ishte zhvilluar ndonjë proces i auditimit të brendshëm nga DAB për AKK-në.

⁶ Kriteret (mbi 1 milion buxhet, 50 staf të punësuar, si dhe shkallë të lartë të rrezikshmërisë).

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Çështja 3 – Mungesa e Planit Strategjik dhe mungesa e monitorimit të rreziqeve

- E gjetura** AKK nuk kishte hartuar planin strategjik, siç kërkohet me procedurata MFK-së, ku përcaktohen objektivat strategjike dhe mënyra e realizimit të tyre në periudhën afatgjate. Po ashtu, AKK kishte përgatitur një listë të menaxhimit të rrezikut e cila kërkohet me rregullat e MFK-së dhe rregullën financiare 01/2010. Megjithatë, ky regjistër nuk menaxhohet në mënyrë sistematike sa i përket azhurnimit dhe monitorimit se si janë ndërmarrë veprime për të zbutur këto rreziqe.
- Rreziku** Mungesa e planit strategjik, pamundëson trajtimin e çështjeve të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e efikasitetit dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara në periudha afatgjate, më tutje mungesa e azhurnimit të regjistrit të rreziqeve ndikon në zvogëlimin e cilësisë së shërbimit.
- Rekomandimi 3** Kryetari AKK-së duhet të siguroj hartimin e planit strategjik/proces të dokumentuar dhe efektiv të mbikëqyrjes së objektivave të përcaktuara. Po ashtu të sigurojë azhurnim dhe monitorim të vazhdueshëm të rreziqeve dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implemtimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Në proces të zbatimit. Plani i veprimit është hartuar, mirëpo nuk janë zbatuar gjitha rekomandimet.	
Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut-Prioritet i lartë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		Në proces të zbatimit. Regjistër i rreziqeve është hartuar, por nuk është monitoruar.	
Dobësi në kontrollet menaxheriale të nivelit të lartë - Prioritet i lartë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të shqyrtojë aranzhimet ekzistuese të raportimit për të siguruar që mangësitë identifikohen, dokumentohen dhe raportohen me kohë me qëllim të evitimit të tyre.			Rekomandimi nuk është zbatuar.

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë	Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.		Në proces të zbatimit. Plani i veprimit është hartuar në vitin 2017, mirëpo janë zbatuar vetëm tri rekomandime.	
Pyetësi i vetëvlerësimit - Prioritet i lartë	Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se është rishikuar plotësisht I pyetësit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit si dhe për të siguruar adresimin e çështjeve të identifikuara. Kryetari i Komisionit po ashtu duhet të sigurojë që është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut dhe të sigurojë raportim dhe monitorim sistematik për zbatimin e kërkesave të këtij procesi.	Rekomandimi është zbatuar.		

Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë	Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2016.		Në proces të zbatimit. Raportimi në nivel të zingjirit llogaridhënës kanë filluar të funksionojnë, por jo plotësisht.	
Shtesë e parregullt për stafin mbështetës – Prioritet i mesëm	Kryetari i Komisionit duhet t'i forcojë kontrollet për të siguruar pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret për kompensimin e punonjësve. Kompensimi i të gjithë punonjësve që kanë themeluar kontratë me Ligjin e punës duhet të jetë subjekt i këtij ligji dhe ndryshimet e nevojshme duhet të reflektohen me kohë në listën e pagave.	Rekomandimi është zbatuar.		
Mos inventarizimi i pasurisë – Prioritet i mesëm	Kryetari i Komisionit duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Rregullores për menaxhimin e pasurisë. Rëndësi e theksuar duhet t'i kushtohet procesit të inventarizimit në fund të vitit për të siguruar që e tërë pasuria është në gjendje të mirë dhe në shfrytëzim për qëllimin e përcaktuar.	Rekomandimi është zbatuar.		

Shtojca III: Letërkonfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:

Prishtinë 06.05.2018

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të AKK-së për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari i AKK-së

Valon PRESTREHI

